



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA MBLEDHJA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 3.03. 2011**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
3.03. 2011. GODINE**

**MARS – MART
2011**

E enjte, më 3.03.2011, ora 11:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar mysafirë,

Të nderuar qytetarë,

Sot, në emër tuaj dhe timin shpreh indinjatën e thellë për aktin e djeshëm kriminal të ndodhur në Aeroportin e Frankfurtit, në Gjermani. Në emër të qytetarëve të Kosovës që përfaqësojmë, në emrin tuaj, deputetë dhe Kabinet qeveritar, i shpreh ngushëllimet tona më të sinqerta presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ushtrisë amerikane, popullit amerikan dhe familjeve të të vrarëve. Dhe, për të vrarët, lus deputetët që të ngrihen në këmbë për një minutë heshtje!

Nderi qoftë me ta!

Të nderuar deputetë,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 109 deputetë, prandaj fillojmë me punën e seancës.

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 15, paragrafi 3 dhe nenin 42 të Rregullores së Punës së Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare Kryesia ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Të nderuar deputetë,

Gjithashtu, ju njoftoj se me kërkesën e Kryetarit të Kuvendit dhe me vendim të Presidentit të Republikës së Kosovës, është bërë zëvendësimi i deputetëve në Kuvendin e Republikës së Kosovës, si në vijim. Pra, zëvendësohen deputetët që kanë kaluar në Kabinetin qeveritar. Pra, janë këta deputetë: Amir Ahmeti, Hydajet Hyseni, Njazi Idrizi, Suzan Noberdaliu, Boban Todoroviq, Nait Hasani, Valbona Dibra, Gëzim Kelmendi, Arsim Bajrami, Berat Buzhala, Kurtan Kajtazi, Fikrim Danka, Jeton Svirca dhe Sasha Milosavleviq. Deputetëve të rinj u dëshiroj punë të mbarë në Kuvend dhe i ftoj që të ngrihen në këmbë:

“Unë, deputet i Kuvendit të Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do të kryej detyrën time, do të përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane”. Betohem!

Ju faleminderit!

Procedojmë me rendin e ditës.

Në pikën e parë të rendit të ditës kemi:

1. Deklarime jashtë rendit të ditës

Në pajtim me nenin 47 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupeve parlamentare zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimet e deputetëve deri në 3 minuta. Andaj, kërkoj nga deputetët e paraqitur për diskutim që të deklarojnë se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

A e do dikush fjalën? Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti, në cilësinë e grupit parlamentar.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit,

Zoti kryeministër,

Kolegë të nderuar,

Ne, faktikisht sot po nisim punën e Kuvendit të ri, të legjislaturës së re me obligime të jashtëzakonshme për gjendjen e vendit tonë dhe të pritshme.

Ne kemi kaluar disa muaj periudhat zgjedhore, të cilat kanë përfunduar me një kualifikim të zgjedhjeve të lënduara. Natyrisht, kemi prodhuar institucionet prapë me një cilësim, me legjitimitet jo të plotë. Pa marrë parasysh gjithë këto të vërteta, ne sot jemi këtu dhe kemi ardhur me votë që të përfaqësojmë interesat e qytetarëve të Kosovës, qoftë pozitë, qoftë opozitë dhe përgjegjësitë janë para qytetarëve dhe janë para vendit edhe para institucioneve.

Lidhja Demokratike e Kosovës, si parti e madhe e me traditë konstitucionale dhe institucionale dhe e madhe edhe në këtë legjislaturë, si partia e dytë, do të punojë në Parlamentin e Republikës së Kosovës për të qar në vend programin fundamental të saj, që Kosova të jetë demokratike, që Kosova demokratike dhe e pavarur mund të ndërtohet vetëm me institucione demokratike, që në këtë udhë kemi për të bërë shumë ende edhe ky legjislacion dhe ai që do të vijë mbas këtij, që për të ndërtuar atë që është ideal i gjithë neve. Po, unë po flas tash për programin tonë të institucioneve demokratike, duhet të krijojmë parakushte të përfaqësimit vërtet popullor e demokratik që do të bëhet në të ardhmen, unë besoj, të kërkuar nga të gjithë me ndryshim të Ligjit zgjedhor, me ndryshim të sistemit zgjedhor. Domethënë, një punë legjislative të cilën e kanë përqaftuar në deklarime të gjitha partitë edhe para kësaj dite.

Në anën tjetër, po them, ne vijmë në bankat e Parlamentit të Republikës së Kosovës që të shqyrtojmë, me gjithë fuqinë dhe dijen që kemi, të gjitha problemet që lidhen me shtetndërtimin, me funksionimin demokratik të këtij shteti, me kërkesën për krijimin e shtetit ligjor, me vendimet e mëdha që presin nga ky parlament qytetarët e Kosovës, qoftë në politikat e jashtme, qoftë në politikat e brendshme zhvillimore. Dhe, ju garantojmë qytetarëve dhe këtij parlamenti, që do të jemi zëri i fortë i kërimit të së vërtetës në secilin rast dhe zëri i fortë i korrigjimit të veprimeve qeveritare që ne do t'i konsiderojmë jo të dobishme për Kosovën, siç do të jemi mbështetës të jashtëzakonshëm të punëve të mira për Kosovën.

Pra, zoti kryetar,
Zoti kryeministër, Kabinet qeveritar dhe deputetë të nderuar,
Ne edhe njëherë theksojmë që pa institucione demokratike nuk ka vend demokratik, pa votë të lirë demokratike, nuk ka përfaqësim të vërtetë, pa sundim të ligjit, nuk ka luftë kundër korrupsionit. E unë po ju them, ju e dini po aq sa unë, po unë po e nënvizoj tash, asnjëra prej këtyre qëllimeve, as integritet, as zhvillimi ekonomik, as mirëqenia qytetare në këtë vend nuk mund të ndërtohet pa luftën e pakompromis kundër korrupsionit. Korrupsion nuk është, qysh e shpjegojnë shumica, veç të vidhet diçka, t'i merret diçka prej xhepit, korrupsion është ...

KRYETARI: Faleminderit, Sabri, koha ka kaluar!

SABRI HAMITI: ... Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, edhe prej juve!
Pasi kartelat nuk po punojnë, a e do dikush tjetër fjalën?
Nëse jo, kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 21 dhe 22 shkurt 2011

Pyes, a ka dikush vërejtje në këto procesverbale?
Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli, kryetar i Grupit të Aleancës së Re të Kosovës.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!
I nderuar kryeministër,
Të nderuar kolegë,
Unë kam vetëm një vërejtje që ndoshta më tepër lidhet me transkriptin, por po ashtu edhe me pjesën e procesverbalit. Në faqen 33 të transkriptit, ku, ose në vendimin, votimin për Qeverinë, nëse nuk gaboj dhe do të duhej të konsultohesh mirë kjo pjesë, më duket që kryesuesi i seancës e ka ftuar presidentin ose është deklaruar që presidenti nuk është në sallë dhe po ashtu e keni 65 vota "për" Qeverinë. Do të duhej që vota e presidentit të mos numërohej dhe të jetë 64 vota "për" Qeverinë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Ardian Gjini e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Mendoj se s'kemi nevojë t'ia nisim edhe këtij Kuvendi, duke i lënë shije sikur atij paraprakut. Nëse dikush do t'ia përkthejë se çka tha zoti Makolli, është kështu: ai tha – "ne e kemi bërë, por po e shkruajmë që s'e kemi bërë", publikisht para kamerave, në transmetim të drejtpërdrejtë.

Zoti Makolli, çka kishe bërë ti sikur personi në fjalë të mos ishte bërë president, qysh kishe reaguar? Nuk guxon Kuvendi t'ia nis në mbledhjen e vet të dytë, të thotë – “po e shkruajmë që s’ e kemi bërë, edhe pse e kemi bërë”, edhe pse e ka parë krejt populli, edhe pse ka qenë në transmetim drejtpërdrejt. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ibrahim Makolli, replikë.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit shumë për përkthimin, koleg. Nuk e kam besuar që po flas me përkthyes, por faleminderit shumë! Nuk e thashë të mos numërohet, por thashë të mos numërohet si votë e vlefshme, që ka shumë dallim prej asaj që u interpretua, që të mos jetë votë e vlefshme, sepse nuk mund të jetë votë e vlefshme. Faleminderit!

KRYETARI: Veç shkurt, Ardian!

ARDIAN GJINI: Kur flitet përçartë, ka nevojë për përkthim. Zoti Makolli lypi të ndërrohet transkripti dhe procesverbali. Zoti Makolli nuk tha, - ne po themi që s’ bën të konsiderohet e vlefshme vota e zotit Pacolli. Lype të ndërrohet transkripti. Nryshimi i transkriptim është të shkruhet çka nuk ka qenë. Tanskripti e transmeton atë që ka ndodhur në Kuvendin e Kosovës dhe ndërrimi i transkriptim, edhe një herë po më duket që ka nevojë për përkthim, është të themi ne – “hajde të themi çka nuk ka qenë”. Ju faleminderit!

KRYETARI: Konstatoj se vërejtja nuk ishte për ta ndryshuar, prandaj konstatoj se procesverbali mbetet ai i mbledhjes së 21 dhe 22 shkurtit 2011. A jeni dakord? Vazhdojmë.

Qeveria, urdhëro, mund ta bëni një sqarim, por procesi nuk mund të ndryshohet.

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë mendoj se sqarimi është në këtë drejtim. Besoj që më së pari Kuvendi nuk e ka kompetencën për ta miratuar transkriptin dhe nuk po kërkon kush për ta ndryshuar transkriptin dhe nuk është pikë e rendi i ditës transkripti.

Sa i përket procesverbalit, askush nuk do të kërkojë që të thuhet që s’kanë votuar 65 veta, por besoj administrata e Kuvendit ka qenë dashur të thotë, 64 janë të vlefshme dhe ky është ndryshimi që duhet të jetë. Dhe, tek e fundit, miratimi i procesverbalit në fund shkohet me vota. Faleminderit!

KRYETARI: Kush është për kërkesën që e bëri deputeti Ibrahim Makolli? Kush është “për”? Faleminderit! Kush është “kundër”? Kush abstenon? Konsideroj që shumica ishin “kundër”. Procesverbali mbetet ashtu siç ka qenë.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin mars të vitit 2011

Qeveria e Republikës së Kosovës ka parashtruar në Kuvend, për shqyrtim dhe miratim, Propozim – vendimin për zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin mars të vitit 2011, të përcaktuara me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010.

Radha e diskutuesve, fjalën e ka ministri i Financave, Bedri Hamza.

BEDRI HAMZA: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Krasniqi!

I nderuar kryeministër, zoti Hashim Thaçi,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Deputete dhe deputetë të nderuar,

Më lejoni që para jush të paraqes kërkesën e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vazhdimin e ndarjeve buxhetore të vitit 2010, të cilat do të shfrytëzohen nga organizatat buxhetore edhe për një muaj, që nënkupton muajin mars.

Sikur të gjithë që jemi të informuar, ne kemi hyrë në vitin 2011, pa buxhet të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Mosaprovimi i buxhetit ka ndodhur për shkak të mbajtjes të zgjedhjeve nacionale në dhjetor të vitit 2010 dhe zgjatjes së këtij procesi dhe krijimit të institucioneve të reja të Kosovës.

Në mungesë të Ligjit të aprovuar për ndarjet buxhetore për vitin fiskal 2011, ne kemi vepruar me dy të dymbëdhjetat e ndarjeve buxhetore nga viti 2010, ashtu siç parashihet me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, në nenin 24, pika 1 të këtij ligji, ku në pikën a) thuhet: “Nëse zgjedhjet e përgjithshme për deputetë të Kuvendit të Kosovës janë mbajtur më pak se 4 muaj para fillimit të vitit fiskal, buxheti zgjatet për të mbuluar dy muajt e parë të vitit fiskal, siguron një ndarje buxhetore për çdo organizatë buxhetore që është e barabartë me 16 e 2/3 e përqindjes ose 16.67% të ndarjes buxhetore të siguruara për organizatën e tillë buxhetore nga Ligji i ndarjeve buxhetore dhe automatikisht mundëson për dy muajt e parë zgjatjen e ndarjeve buxhetore, që kanë siguruar 2/12 e ndarjeve buxhetore të vitit 2010, për muajin janar dhe shkurt.

Më datën 28 shkurt të vitit 2011, kanë skaduar të gjitha ndarjet buxhetore, të cilat ishin të ndara për muajin janar dhe muajin shkurt.

Duke u bazuar në autorizimet që i ka dhënë ligji përkatës për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të cilët i cituam më lartë, ne nuk kemi të drejtë ligjore që të vazhdojmë më tutje me lejimin e ndarjeve buxhetore dhe alokime për organizatat buxhetore.

Për ta siguruar vazhdimësinë dhe mosndërprerjen e aktiviteteve normale të organizatave buxhetore gjatë muajit mars, periudhë kohore kjo gjatë së cilës presim ta finalizojmë

buxhetin e plotë të vitit 2011, kërkojmë nga ju që të bëni aprovimin e zgjatjes të ndarjeve buxhetore edhe për një muaj. Kërkesa është e bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, përkatësisht në nenin 24, pika 2, sipas të cilit aprovimin e tillë mund ta bëjë vetëm Kuvendi.

Në këtë nen, do të thotë, në nenin 24, pika 2, thuhet: “Vetëm Kuvendi me anë të një vendimi mund të autorizojë zgjatjen e Ligjit për ndarjet buxhetore të vitit të kaluar fiskal”. Ligji për ndarjet buxhetore i vitit të kaluar fiskal, në asnjë rast nuk mund të zgjatet për më shumë se 3 muaj të vitit fiskal.

Të nderuar deputetë,

Aprovimi i juaj për vazhdimin e ndarjeve buxhetore edhe për një muaj është shumë i rëndësishëm për institucionet e Republikës së Kosovës, si në nivelin qendror, po ashtu edhe për institucionet në nivelin lokal, ku me këtë do të mundësohet sigurimi i ndarjeve buxhetore totale për organizatat buxhetore deri në fund të muajit mars, që arrijnë në 25% të buxhetit të vitit 2010, apo e barabartë me 3/12 e ndarjeve buxhetore, ndërsa brenda të një afatit optimal, por gjithsesi brenda afatit të përcaktuar me ligj do të sjellim për aprovim në Kuvend Ligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2011. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër Hamza!

Tani është radha për t’u deklaruar shefat e grupeve parlamentare.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike ose përfaqësuesin e Grupit, deputeten Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Përshëndetje, zoti kryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për kryeministrin, zëvendëskryeministrat dhe Kabinetin qeveritar!

Përshëndetje për juve kolegë të nderuar deputetë!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar vendimin e Qeverisë që na ka sjellë me kohë. Duke marrë parasysh rrethanat në të cilat u ndodhëm për shkak të zgjedhjeve, shtyrjes së aftit zgjedhor, ne e përkrahim vendimin e Qeverisë, me pritjen që Qeveria në afatin sa më të shpejtë kohor të na sjellë buxhetin dhe të kemi mundësi ne, si Kuvend, ta bëjmë shqyrtimin e tij ashtu siç duhet ta bëjmë shqyrtimin ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës. Prandaj, ftojme edhe të gjithë deputetët që ta përkrahin këtë vendim të Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kryetari i Grupit, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke mos dëshiruar në asnjë mënyrë të bllokojë funksionimin e institucioneve tona, e mbështet kërkesën që ky Kuvend t’i lejojë edhe për një muaj këto mjete që kërkojnë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Kryetar i Kuvendit të Kosovës,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Ndarja e buxhetit për vitin 2010, nuk ka qenë diçka për të cilin as që mund të lavdërohet Kosova, po as diçka prej të cilës ka përfituar shumë Kosova.

Gjatë vitit 2010, ne kemi shpenzuar më së shumti, marrë për sektorë, në infrastrukturën rrugore, në projekte të paplanifikuara mirë, të cilat nuk i sollën asnjë përfitim Kosovës, si shtet, e as qytetarëve të Kosovës. Ndërkohë, janë lënë anash tërësisht ata sektorë të ekonomisë të cilët do ta zbusnin papunësinë dhe do ta përmirësonin bilancin tregtar të Kosovës dhe do t'ia përmirësonin jetën qytetarit të Kosovës, pra është lënë anash tërësisht prodhimi.

Investimet në infrastrukturën rrugore janë të mira dhe të mirëseardhura, mirëpo në rrethanat në të cilat jetojmë ne, me papunësi e varfëri që e ka kapluar gjysmën e popullatës, me raport 1:10 të eksportit me importin, me shkatërrim sistematik të tokave bujqësore përmes ndërtimit e lënies djerrë, me degradim të vazhdueshëm të kapacitetit industrial të vendit përmes shitjes, që po quhet këtu privatizim, me degradim të vazhdueshëm të rrjetit të energjisë për shkak të mosfinancimit, me degradim të vazhdueshëm të cilësisë së arsimit e të shëndetësisë së qytetarëve, me nëpërkëmbje të vazhdueshme të të drejtave të pensionistëve, investimet shumë të shtrenjta në ndërtimin e rrugëve e auto udhëve moderne, nuk mund të jenë prioritet ekonomik, aq më pak ato mund të jenë prioritare, nëse me to ose kur kihet parasysh që do të vazhdojnë të jetojnë me to njëjtë, sikurse kemi jetuar edhe pa to.

Nga ne sot këtu është kërkuar që ta votojmë zgjatjen edhe për një muaj të shfrytëzimit të 1/12 së buxhetit të vitit të kaluar për administratën shtetërore për muajin mars, prandaj edhe e bëra këtë hyrje për buxhetin e vitit të kaluar, por problemet në këtë buxhet nuk përfundojnë këtu. Është bërë e zakonshme në Kosovë që përdorimi i parasë publike të jetë zakonisht i keq, pra të jetë keqpërdorim dhe ky keqpërdorim, me kalimin e kohës ka filluar të bëhet edhe publik. Rastin më eklatant të kësaj e kemi vendimin fundit të Qeverisë së kaluar për ngritje të pagave të sektorit publik për 50%, vendim ky që na u shfaq në formën e premtimit elektorale, pra si metodë perfide e blerjes së votave dhe i cili, së paku deri tash, mbeti vetëm si i tillë, premtim elektorale, i cili nuk u zbatua si shumë të tjerë.

Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje”, do të votojë për ta lejuar përdorimin e 1/12 së buxhetit për muajin mars. Këtë e bëjmë për shkak se jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e funksionimit të institucioneve shtetërore dhe të atyre publike të Kosovës dhe për rëndësinë që pagat kanë për shërbyesit civilë. Por, po ashtu shprehim pakënaqësinë tonë me këtë mënyrë të ndarjes dhe shpenzimit të parasë publike. Prandaj, i bëjmë thirrje Qeverisë së vendit që buxhetin e Kosovës ta marrë më seriozisht dhe që ndarja buxhetore domosdo të reflektojë interesat e vendit dhe të qytetarëve të Kosovës e jo ato të ministrave të kabinetit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kosovës, edhe një herë,
Fjalën e fundit, të parën prapë, me siguri se Grupi Parlamentar i Aleancës do ta votojë këtë shtyrje të këtij pozicioni për shkak se mësuesit, mjekët e të gjithë të tjerët, të gjithë që marrin rrogë prej buxhetit të Kosovës, janë pa rroga dhe nuk mund të vazhdojmë ta lëmë popullin e Kosovës, administratën edhe shtetin kësisoj. Sidoqoftë, duhen nja dy ose tri komente të bëhen për situatën në të cilën kemi mbërri.

Nëse dikush e sheh, do të thotë, në karriget e qeverisë mbrapa meje janë 12 njerëz të cilët kanë qenë në Qeverinë e kaluar, 5 janë që nuk kanë qenë dhe këta kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në hartimin e buxhetit që prej muajit, diku shtator të vitit të kaluar. Këta e kanë hartuar buxhetin për vitin 2011. Arsyeja pse ne sot e shtyjmë buxhetin e vitit 2010 dhe nuk e miratojmë buxhetin e vitit 2011, të paktën në lexim të parë, është se këta kanë premtuar se kanë për t'i rritur rrogat dhe tash nuk mund t'i rrisin rrogat deri sa t'i gjejnë të hollat, se s'kanë të holla për t'i rritur ato rroga. Kjo është arsyeja. Dhe ministri i financave, me krejt respektin, në vend se të na lexojë ligjin neve këtu, ne e dimë ligjin, në vend se të na lexojë ligjin, ka qenë mirë të na shpjegojë esencialisht pse kemi ardhur deri këtu. Pse është kjo gjendje në të cilën jemi ne, për shkak se buxheti nuk është aprovuar as në Qeveri të Kosovës, jo vetëm në Kuvend, por nuk është aprovuar në Qeveri. Do të thotë, ne në këtë situatë që jemi, mund të arrijmë deri në fund të muajit mars, pa buxhet, për shkak se nuk kanë të holla për t'ua rritur rrogat njerëzve që u kanë premtuar dhe mendoj se Kuvendi i Kosovës sot, kur e shtyn këtë provizion, kur e zgjatë këtë sistem të pagesës të vitit 2010 edhe për një muaj, duhet të insistojë që ata që kanë premtuar për t'i rritur rrogat, t'i rrisin, mos të vijnë një ditë këtu e të na thonë s'po na lë FMN-ja, mos të vijnë të na thonë s'po na lë Banka Botërore, mos të vijnë e të na thënë s'kemi mjete për shkak se janë këta të njëjtit njerëz që e kanë ditë saktë sa mjete i kanë në arkën shtetërore në momentin kur kanë premtuar se kanë për t'iu rritur njerëzve rrogat dhe efektivisht pajtohem, në mënyrën më perfide janë blerë votat e qytetarëve të varfër të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputeti Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e mbështet kërkesën e Qeverisë për aprovimin e kësaj pjese të buxhetit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, fjalën e ka deputeti Sasha Rashiq.

SAŠA RAŠIĆ: Poštovani predsjedniče, premijeru, kolege narodni poslanici, Parlamentarna grupa SLS je razmotrila predlog odluke Vlade za raspodelu budžeta za mart 2011. godine i istu podržavamo u potpunosti. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputeti Rasim Demiri e ka fjalën.

RASIM DEMIRI: Poštovani predsedniče,
Poštovani premijeru,
Poštovani ministri,
Poštovane kolege,
Parlamentarna grupa “6+” podržava zahtev Vlade za usvajanje budžeta za mesec mart.
Hvala, puno!

KRYETARI: Faleminderit! Pasi kryetarët e grupeve i kryen fjalët e tyre, a do dikush fjalën prej deputetëve? Nëse jo, atëherë fjalën e ka kryeministri, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,
Ne shumë shpejt do ta sjellim Projektbuxhetin në Kuvend pasi që Qeveria e Kosovës është zgjedhur tash e tetë ditë dhe natyrisht se konsultat janë të nevojshme dhe të domosdoshme. Në projektbuxhet do të jenë të përfshirë edhe premtimi për rritjen e pagave, ashtu siç kemi premtuar dhe garantuar. Pres që Kuvendi ta miratojë këtë muaj, kam besim të plotë, këtë projektbuxhet. Se sa do të vonohet, do të varet edhe nga ju, do të thotë nga Kuvendi, sepse Qeveria do të procedojë në kohë të rregullt dhe procedura të rregullta. Gjithashtu, dëshiroj të theksoj se edhe sa i përket kësaj vonese, të gjithë qytetarët e dinë pse ka ardhur deri te kjo vonesë për shkak të zhagijtes së madhe të procesit elektorale, të gjithë spektrit politik, por më së tepërmi të atyre që s’pajtoheshin me vullnetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Unë falënderoj opozitën që e ka thyer bojkotin dhe i është kthyer Kuvendit prej nga është zgjedhur edhe prej qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja... Po Arben, me kohë s’je lajmëruar, e ka njëfarë rendi edhe ky Kuvend, se je i ri!

ARBEN GASHI: I nderuar kryetar,
Të nderuar deputetë,
Faleminderit që jam i ri, e di që jam i ri, po e di që edhe duhet të potencohen disa fakte këtu. Po, edhe kjo është e vërtetë. Fakt që buxheti i Republikës së Kosovës ose Ligji për buxhetin nuk është proceduar vitin e kaluar, fakt që është bërë shkelje e procedurave, fakt që nuk është respektuar vullneti i qytetarëve në zgjedhjet që janë mbajtur, fakt që kryeministri këtu na mban fjalim dhe na thotë se disa të pakënaqur e paskan kundërshtuar procesin dhe e paskan stërzgatur. Është fakt që ligjet garantojnë që për çdo parregullsi të përdoret sistemi. Sistemi kur përdoret, është një e drejtë legjitime dhe askush nuk mund të pretendojë se zgjatja e tillë paska një pasojë, e cila është mosmiratimi i Buxhetit të Kosovës. Ne do të kemi kohë dhe do të diskutojmë, do të diskutojmë për buxhetin dhe do të diskutojmë për abuzimet që janë bërë me vullnetin e qytetarëve të Kosovës, po ashtu

do të diskutojmë edhe për abuzimin që është bërë me premtimin për rritjen e pagave për punonjësit në sektorin publik. Në atë kohë kur do të diskutojmë për buxhetin, do t'i shfaqim të gjitha pikëpamjet tona. Mirëpo, paraprakisht ia kujtoj kryeministrit dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës se ne jemi në situatë ekonomike në të cilën sot rrezikojmë edhe qëndrueshmërinë financiare, edhe qëndrueshmërinë ekonomike dhe rritja që është premtuar është rritje zero, sepse kemi inflacionin më të madh se sa rritjen. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, unë realisht po kërkoj nga deputetët, sidomos nga deputetët e rinj, ishte fjala për të marrë fjalën deputetët, nuk e morën fjalën dhe mos të ndikohen nga diskutimi që s'ishin për ta vazhduar. Prandaj, hymë në procedurën e votimit. Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 114 deputetë. Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për votimin. Kush është “për”?

Faleminderit!

A ka “kundër”?

A ka ndonjë abstenim? Nuk ka.

Pra, me votimin e të gjithë të pranishmëve, konstatoj se me vota “për”, pa asnjë “kundër”, pa asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Vendimin për zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin mars të vitit 2011, të përcaktuar në Ligjin numër 03/L-218 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-177 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010. Urdhëro kryeministër, një informatë!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ndjej obligim kushtetues, ligjor, por edhe moral që në kuadër të transparencës së plotë të proceseve politike në të cilat po kalojmë, natyrisht, edhe Kuvendi, edhe Qeveria dhe Presidenca, të gjitha institucionet legjitime dhe demokratike të Republikës së Kosovës, por edhe si vend, si qytetarë, si institucione tanimë ndodhemi në një proces të vazhdimësisë së mëhershme, pra para një procesi të rëndësishëm për të ardhmen evropiane të Republikës së Kosovës. Për herë të parë, prej përfundimit të luftë dhe shpalljes së pavarësisë së Kosovës, do të fillojmë me normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore në mes të Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë. Kjo është një agjendë euro-atlantike që nënkupton vazhdimësi të këtij procesi të filluar dhe zotuar nga institucionet e vendit, prandaj dëshiroj të theksoj se Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendimet e veta në përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës për kryerjen e përgjegjësisë që kemi për bashkëpunim ndër-fqinjësor, duke emëruar edhe njërin ndër zëvendëskryeministrat përgjegjës për çështjen e dialogut për çështje praktike me Republikën e Serbisë dhe ne kemi besim të plotë se do të përmbillet me njohjet reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë, si dy shtete të veçanta për t'u integruar në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Kjo ishte një informatë për ju, për të gjithë qytetarët e Kosovës në kuadër të përgjegjësisë kushtetuese të rritjes së transparencës, por mendoj se fjalën duhet ta ketë edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe në këtë drejtim unë ju inkurajoj për çdo ide, për çdo debat dhe çdo konkluzion të përbashkët të gjithë spektrit politik. Ky është interesi shtetëror i diskutimeve të përbashkëta dhe konkluzioneve të përbashkëta apo rezolutave të përbashkëta pastaj, për implementimin e tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për të vazhduar debati për këtë pikë të rendit të ditës, një herë duhet të deklarohejmë a po e fusim në rend të ditës...? Mirë, atëherë e marrim si informatë dhe me këtë konstatojmë përfundimin e seancës së sotme. Mirupafshim në seancën e radhës! I kisha lutur deputetët e ri që të mbesin në sallë!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve